



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2018:065886

Datë: 12.02.2021

Numri i dokumentit: 01504010

P.nr.1015/18

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin e vetëm gjykues Rilind Sermahaj, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Eronita Llapashtica, në çështjen penale kundër të akuzuarit A.. M... nga Gj..., për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 paragrafi 1 lidhur me nenin 77 të KPRK-ës, duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, me numër PP.II.nr.1765/2018, të datës 06.11.2018 dhe PP.II.nr.150/2019, të datës 07.02.2019, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor me datë 12.02.2021, mori dhe publikisht shpalli këtë:

AKTGJYKIM

I akuzuari A... M..., nga babai R..., dhe nëna A., e lindur A..., i lindur me datë..., në fshatin S..., Komuna e B..., ndërsa me vendbanim në..., i martuar, baba i dy fëmijëve, i punësuar si menaxher i lokalit “Adriatika” në Përlepnice, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së varfër ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës dhe Serbisë,

ËSHTË FAJTOR

I.

Më datë 21.06.2018 në lokalin e tij të restaurant “...” te “..” Komuna e Gj..., i akuzuari A...M..., si shfrytëzues i energjisë elektrike, me qëllim që vetit ti sjellë përfitim të kundërligjshëm pasuror, ka shfrytëzuar në mënyrë të paautorizuar energjinë elektrike, në atë mënyrë që nga punëtorët e autorizuar të K...it, Ekipa e Kontrollës, është konstatuar se pasi që i akuzuari njehsorin elektrik e ka të vendosur me komandë nga distanca (AMR) dhe për shkak të mos pagesës së borxhit, është shkyçur, por gjatë kontrollimit është vërejtur se i njëjti është lidhur direkt, duke i vendosur daljet në hyrje të njehsorit ku si pasojë energjia e shpenzuar nuk është llogaritur, dhe në këtë mënyrë i akuzuari me veprimet e veta të dëmtuarës KEDS-it, Distrikti në Gjilan, i ka shkaktuar dëm material në shumë prej rreth ....euro.

II.

Më datë 13 Tetor 2018, në restaurant “...” në fshatin P..., K... e Gj..., pas vërtetimit të gjendjes faktike të njehsorit, nga punëtorët e autorizuar të..., është konstatuar se, i akuzuarit A... M... si shfrytëzues i energjisë elektrike, në mënyrë të paautorizuar është lidhur në mënyrë direkte para pikës matëse edhe pse i njëjti është ç’kyçur nga rrjeti elektrik, kështu që i akuzuari me veprimet e tij e ka dëmtuar, të dëmtuarën ...në vlerë prej rreth .....euro.

-Me çka ka kryer veprën penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 paragrafi 1 lidhur me nenin 77 të KPRK-ës,

andaj, gjykata në bazë të nenit 4,38,39,46,47,48,49,69,70,71 dhe 72 të KPRK-ës dhe neneve 326 e 365 të KPP-ës, të akuzuarin Ahmet Mehmeti:

## E GJYKON

Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 130 (njëqindetridhjetë) ditëve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në periudhën verifikuese prej 1 (një) viti nuk kryen vepër tjetër penale.

E dëmtuara....., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko civil.

Obligohet i akuzuari që të paguajë paushallin gjyqësor në shumën prej 30 € (tridhjetë) euro si dhe shumën prej 30 € (tridhjetë) euro për kompensimin e viktimave të krimit, brenda afatit prej 15 ditëve nga dita kur ky aktgjykim të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

## ARSYETIM

### 1.Rrjedha e çështjes

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, kundër të akuzuarit A... M... nga fshati S..., K.. e B..., me datat 06.11.2018 dhe 07.02.2019, ka ngritur aktakuzat me numra ...dhe..., që të dyja për shkak të veprës penale lidhja e paautorizuar në shërbime nga neni 321 të KPRK-ës.

Pranë kësaj gjykate është mbajtur seanca e shqyrtimit gjyqësor në të cilën ishin prezent prokurori i shtetit dhe i akuzuari me ç’rast pas leximit të aktakuzave lëndore i akuzuari i lartcekur kishte deklaruar se i kishte kuptuar në tërësi aktakuzat dhe veprën penale për të cilën akuzohet dhe se nuk ka nevojë për sqarime shtesë ndërsa sa i përket fajësisë i njëjti kishte deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale<sup>1</sup> e cila i vihet në barrë sipas aktakuzës lëndore andaj gjykata pas dëgjimit të palëve dhe në pajtim me nenin 326 të KPP-ës, ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë nga ana e të akuzuarit me ç’rast seanca e shqyrtimit gjyqësor kishte vazhduar me fjalët përfundimtare të palëve.

<sup>1</sup> Gjikata duke vepruar sipas detyrës zyrtare si dhe duke pasur parasysh se ndaj të akuzuarit ishin duke u zhvilluar 2 (dy) procedura penale në të njëjtën kohë, për vepra penale të njëjta, në seancën e shqyrtimi fillestar pas dëgjimit të palëve dhe me qëllim të ekonomizimit të procedurës penale në kuptim të nenit 35 të KPP-ës kishte marrë aktvendim procedural me të cilin kishte bashkuar procedurat penale ndaj të akuzuarit edhe atë për lëndët P.nr.1765/18 dhe P.nr.150/18 dhe më pas para leximit të aktakuzës prokurori i shtetit ka bërë ricilësimin juridik të veprës penale duke i konsideruar veprat penale të lartcekura në një vepër penale në vazhdim nga neni 314 paragrafi 1 lidhur me nenin 77 të KPRK-ës meqenëse plotësoheshin kushtet ligjore për një gjë të tillë.

Prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare kishte deklaruar se meqenëse në seancën e shqyrtimit të gjyqësor i akuzuari ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë pas njoftimit për pasojat dhe benefitet e pranimit të fajësisë dhe se ky pranim i fajësisë është i mbështetur në provat tjera materiale bashkangjitur aktit akuzues, fakte këto dhe prova në bazë të të cilave në mënyrë të pa kontestueshme argumentohet fakti se tani i akuzuari ka kryer veprën penale të përshkruar si në dispozitivat e aktakuzave lëndore, për çka edhe mbetet pranë tyre dhe propozimeve të cilat ato i përmbajnë andaj edhe ka kërkuar nga gjykata që komfor dispozitave ligjore të njëjtin ta shpall fajtor dhe ta dënoj sipas ligjit ndërsa sa i përket caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit ka propozuar që gjykata të merr parasysh rrethanat lehtësuese dhe rënduese me qëllim që dënimi të jetë në proporcion me shkallën e përgjegjësisë së të akuzuarit si dhe rrezikshmërinë e veprës penale.

I akuzuari A... M... në fjalën përfundimtare ka deklaruar kërkon falje për veprimet e tija duke shtuar se këto veprime i ka bërë për shkak të gjendjes së varfër ekonomike, është mbajtës i familjes dhe i njëjti ka premtuar që në të ardhmen nuk do të përsërisë veprën penale andaj nga gjykata ka kërkuar një dënim sa më të butë.

## 2.Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Gjykata pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor në të cilin kanë qenë prezente palët e lartcekura dhe pas dëgjimit të palëve ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë e të akuzuarit për veprën penale për të cilën akuzohet ngase ka konstatuar se janë plotësuar gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë si në kuptim të nenit 326 të KPP-ës paragrafi 1 lidhur me nenin 248 paragrafi 1 të KPP-së dhe se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit nuk është kundërshtuar nga ana e palëve prezente. Në këtë aspekt gjykata ka konstatuar se i akuzuari e ka kuptuar drejtë natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga ana e të akuzuarit, se i akuzuari nuk ka qenë i detyruar ose i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes të cilat i përmban aktakuza siç janë: procesverbali me numër të shifrës së konsumatorit ... i datës 21.06.2018, një foto në vendin e ngjarjes, fatura nga Sektori i Rikthimit të Humbjes me numër .... i datës 22.06.2018, fatura..., e datës..., procesverbali mbi konstatimin e gjendjes faktike në terren me numër..., i datës..., fotografi mbi mënyrën e kryerjes së veprës penale, kalkulimi i RH nga Sektori i Rikthimit të Humbjeve, i datës..., pro-faturë mbi dëmin e shkaktuar ...të datës ...si dhe shkresat e tjera të lëndës po ashtu me rastin e pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarit gjykata gjeti se aktakuza lëndore nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

## 3.Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike: se i akuzuari Ahmet Mehmeti nga Gjilani, për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 paragrafi 1 lidhur me nenin 77 të KPRK-ës, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitivin I dhe II të këtij aktgjykimi.

## 4. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjykata me rastin e matjes së dënimit ka vlerësuar që të akuzuarit duhet ti shqiptohet dënimi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi ngase duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ky dënim do të jetë i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale, sjelljen dhe rrethanat e kryesit si dhe përgjegjësinë penale të tij, gjykata me rastin e matjes së dënimit pati parasysh rregullat e përgjithshme për matjen e dënimit si në kuptim të nenit 69 të KPRK-ës ashtu që gjykata mori parasysh shkallën e përgjegjësisë penale të kryesit e cila nga provat materiale në shkresat e lëndës del të

jetë e lartë meqenëse i akuzuari me rastin e kryerjes së veprës penale ka qenë i përgjegjshëm për veprimet e tija, me rastin e caktimit të dënimit gjykata pati parasysh edhe rrethanat personale të kryesit dhe atë se për të ishte hera e parë që bie ndesh me ligjin, është mbajtës i familjes 4 anëtarëshe dhe baba i dy fëmijëve.

Me rastin e matjes së dënimit gjykata pati parasysh edhe rregullat e përgjithshme të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit si në kuptim të nenit 70 të KPRK-ës ashtu që si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin gjykata mori faktin se i njëjti ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihej në barrë në një fazë të hershme të procedurës penale, i njëjti është penduar dhe ka shfaqur keqardhje për veprimet e tij, ka kërkuar falje për këto veprime, faktin se i njëjti ka premtuar që në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla dhe as vepra të tjera penale, ndërsa si rrethanë rënduese për të akuzuarin gjykata nuk gjeti ndonjë gjithashtu duke u bazuar në të lartcekurat dhe në kuptim të nenit 71 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të KPRK-ës gjykata të akuzuarit ia shqiptoj dënimin brenda kufijve të paraparë ligjor të paraparë si në nenin 72 të KPRK-ës, gjithnjë duke konsideruar se me dënimin e shqiptuar ndaj të akuzuarit mund të arrihen qëllimet e dënimit si në kuptim të nenit 38 të KPRK-ës të cilat konsistojnë në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tij, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehjen e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

#### 5. Vendimi lidhur më kërkesën pasurore juridike

Duke pasur parasysh se të dhënat në këtë çështje penalo juridike nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë e as të pjesërishtë të kërkesës pasurore juridike gjykata në bazë të nenit 463 paragrafi 2 të KPP-ës të dëmtuarën KEDS për realizimin e kërkesës pasurore juridike e udhëzoi në kontest të rregullt juridiko civil.

#### 6. Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Duke pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale, gjykata duke u bazuar në nenin 451 paragrafi 1 të KPP-së, ka vendosur që të pandehurën ta detyrojë ta paguajë paushallin gjyqësor në shumën prej 30 € (tridhjetë euro) euro si shumën prej 30 € (tridhjetë) euro për kompensimin e viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Andaj duke u bazuar në të lartcekura gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN  
Departamenti i Përgjithshëm  
P.nr.1015/18, me datë 12.02.2021

Zyrtarja Ligjore,  
Eronita Llapashtica

Gjyqtari i vetëm gjykues,  
Rilind Sermaxhaj

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimin të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet Gjykatës Themelore në Gjiilan.